



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA POLIÇAN
NJESIA E PROKURIMIT**

Nr. ___Prot

Polican , me __.__.2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës- PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT:

**“Rikonstruksioni dhe Rehabilitimi i rrugëve të varrezat e vjetra, lagjia Kalluç dhe pallati
katër katësh Poliçan”**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

45000000-7 Pune ndertimore , 45453000-7 Riparim dhe renovim

PËRCAKTIMI DHE ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE :

Në përcaktimin e specifikimeve teknike, grupi i punës u mbështet në:

Specifikimet/Relacioni Teknik/preventive dhe grafiku per proceduren respektive jane hartuar nga subjekti i licensuar qe ka hartuar edhe projekt/ preventivin perkates te zbatimit duke qene elemente perberes te tij dhe jane verifikuara nga specialistet e fushës nga Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit të Territorit. *Specifikimet Teknike të Përcaktuara në këto Dokumente janë kontrolluar dhe jane gjetur në përputhje të plotë me kërkesat e ligjit nr.162 datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”.*Specifikimet Teknike jane pjese e setit te dokumentave te ngarkuara ne SPE per proceduren respektive.

Vendosja dhe argumentimi i kriterëve/Hartimi i kërkesave për kualifikim lidhur me kapacitetet teknike, argumentimi i numrit te punonjesve dhe numrit te mjeteve dhe makinerive për këtë objekt prokurimi është bërë nga specialisti i fushës, inxhinier I DPZHT bashkia polican anëtar i njësisë së prokurimi, në respektim dhe të parashikimeve të nenit 74/4 të të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.Kriteret e vecanta ekonomike jane hartuar nga ekonomisti specialist i fushes antare i njesise se prokuimit dhe kriteret ligjore nga juristi specialist i fushes antare i njesise se prokurimit

VLERA E FONDIT LIMIT: 16 666 407 leke(gjashtembedhjete milion e gjashtëqind e gjashtedhjete e gjashte mij e katerqind e shtate)leke pa tvsh dhe 19 999 688 (nentembedhjete

milion e nentëqind e nentëdhjetë e nente mij e gjashtëqind e tetëdhjetë e tete) lek me TVSH. Burimi i financimit: Nga buxheti i bashkise 2023 (granti dhe te ardhurat e bashkise Poliçan).

Fondi Limit i perlllogaritur per kete procedure eshte hartuar ne baze te VKM nr 629 date 15.07.2015 "Per Miratimin e Manualeve Teknike te Cmimeve te Ndertimit dhe analizat teknike te tyre" i ndryshuar , nga subjekti projektues dhe eshte verifikuara nga specialistet e fushës , inxhinier prane Drejtorise se Planifikimit, Zhvillimit të Territorit, në zbatim të urdhërit të brendshëm të titullarit të AK "Mbi Përgatitjen e kriterëve Teknike dhe Përlllogaritjen e Vlerës Limit të planifikuar për tu kryer në programet e investimeve, bazuar ne dokumentat sipas buxhetit te bashkise te vitit 2023 të miratuara nga Këshilli Bashkiak si dhe dokumentave lidhur me projektin, preventivin dhe specifikimet teknike të punimeve.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", autoriteti/enti kontraktor Bashkia Polican ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Per kapacitetin ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

Sipas percaktimeve te bera ne Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/ Kualifikimit).Kjo pikë plotësohet me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar.

2.2. Per kapacitetin ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare, **2019,2020 dhe 2021**,ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontrates pasi proceduar eshte ndermjete kufirit te larte dhe te ulet monetar. .

Argumentimi: Këto kritere janë vendosur në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, bazuar në neni 42 të Aktit Normativ 9/2019, nenin 77, pika 3, e LPP dhe nenit 43, pika 5, e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” Autoriteti në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.”

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në neni 29, pika 1 të Ligjit nr.8438 datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar.

Bazuar në rekomandimin e app nr. 7998 prot date 24.12.2021 e cituar :

Nisur nga problematikat që konstatohen në hartimin e këtij kriteri, si dhe bazuar në parashikimet e nenit të sipërcituar, rekomandojmë që hartimi i kriterit të xhiros mesatare vjetore, të jetë si më poshtë:

"Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare..... (shënim: në çdo rast autoritetet/entet kontraktore duhet të përcaktojnë vitet konkrete, të cilat duhet të jenë deri në 3 vitet e fundit financiare), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se:

-dyfishi i vlerës së parashikuar të kontratës (në rast se procedura është mbi kufirin e lartë monetar).

-vlera e parashikuar e kontratës (në rast se procedura është ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar).

-40 % të vlerës së parashikuar të kontratës (në rast se procedura është nën kufirin e ulët monetar, ose "Shërbim konsulence").

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2019,2020 dhe 2021**, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “ Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar.

Kjo kërkesë konsiderohet e përbushur nëse bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk kanë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe neni 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjisllacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda

datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".

Bazuar në rekomandimin e app nr. 7998 prot date 24.12.2021 e cituar :

Gjithashtu, autoritetet/entet kontraktore mund të kërkojnë edhe bilancet vjetore të operatorëve ekonomikë, për një periudhë deri 3 vitet e fundit financiare. Në rast se kërkohen bilancet e 3 viteve të fundit financiare, rekomandojmë që autoritetet/entet kontraktore të përfshijnë në kriter përcaktimit që kriteri quhet i përmbushur nëse bilancet e dy viteteve të njëpasnjëshme, nuk kanë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Në rast se kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Së fundmi, në lidhje me këtë kriter, për sa i përket viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros mesatare vjetore dhe bilanceve, rekomandojmë që AK të përcaktojnë specifikisht vitet konkrete të kërkuara për paraqitjen e këtyre dokumenteve (deri në 3 vitet e fundit financiare), duke mbajtur në konsideratë edhe parashikimet e legjislacionit të fushës, aktualisht, nenin 29, të Ligjit Nr. 8438, dt. 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar, ku përcaktohet: *Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës".*

2.2.3 Një dokument lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore që vërteton se subjekti i ka plotësuar detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, për vitin 2022 , dhe kestet të maturuara të vitit 2023 , referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, si dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak përkatës ku subjekti ushtron aktivitetin për të gjitha vendet ku ushtron aktivitet sipas ekstratit të QKR. (në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument).

Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit përmbledhës të Vetë deklaramentit sipas shtojcës 8 në DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar).

2.3.Kapaciteti teknik:

2.3.1.Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet , konkretisht në vlerën 8 333 203 ⁵(tete milion e treqind e tridhjetë e tre mij e dyqind e tre pike pese) lek pa tvsh dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet, konkretisht 33 332 814 lek(treidhjetë e tre milion e treqind e tridhjetë e dy mij e teteqind e katermbdhjetë lek) pa tvsh..

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

- a) Si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkojme vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
- Kontratë Sipërmarrje
- Situacionin përfundimtar;
- Fatura tatimore,
- Aktin e kolaudimit; *(në rastet kur ky dokumentacion lëshohet)*
- Çertifikatën e marrjes në dorezim/Çertifikatën e Përkohshme/perfundimtare të marrjes në dorezim.

Shënim:*Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, kërkojme si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Vërtetim lëshuar nga subjekti privat shoqëruar me:
- Kontrate Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Fatura tatimore,
- Akt kolaudim i objekti; *(në rastet kur ky dokumentacion lëshohet)*

Shënim:Vertetimi duhet te percaktoje saktësisht cilësinë e kryerjes se punëve dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.

Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë:

- Kontraten e bashkimit te operatoreve dhe prokuren e posacme te deklaruar ne fazen e tenderimit;
- Per kontratat e realizuara si Nenkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë:
 - a) Kontratë baze ndermjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe
 - b) Miratimin zyrtar si nenkontraktor nga ana e Autoritetit Kontraktor.

Pika 2.3.1 germa a) plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.. Në rastin kur operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesmarje në bashkim, vendosin me marveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të permbushë këtë kusht.

Kurse pika 2.3.1 germa /b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit **në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.** (Neni 88, pika 3, i VKM-se nr.285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vleren jo me te vogel se 50 % të vlerës së perlllogaritur te kontrates, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

- Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

- Pasi vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e ulët monetar. Vlera për punë të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvoje duke patur parashysh objektin dhe vlerën e kontratës. Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2. Operatorët ekonomike duhet te paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas formatit të miratuar me Vendim te Keshillit te Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008, ”Per miratimin e rregullores per kriteret dhe Procedurat e dhenies se licencave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi”. Shqyrtimi i licencave do te

behet mbi bazen e rregullave te parashikuara sa me siper. Licenca profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e puneve te kontrates duhet te permbaje kategorite e meposhtme:

PUNIME TE PERGJITHSHME NDERTIMI

- NP-1 A Punime gërmimi në tokë
- NP – 2 A Ndërtime civile dhe industriale
- NP-4 A Rruge, autostrada, mbikalime, hekurudha , tramvaj, metro, pista aeroportuale
- NP-7 A Ujesjelles, gazsjelles, vajsjellesa, vepra kullimi e vaditje.

PUNIME SPECIALE NDERTIMI

- NS -1 A Punime për prishjen e ndërtimeve
- NS -18 A Punime topogjeodezike

Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastruktues dhe Energjise, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, e miratuar me VKM- ne, Nr.42, date 16.01.2008). **Mosparaqitja ne kete forme eshte kusht skualifikues.**

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, pika 1 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6/a, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.*

Për sa më lart, me qëllim realizimin e punës objekt prokurimi, është kërkuar që Ofertuesit të jenë të pajisur me Licencë profesionale për kategoritë, të cilat janë vendosur sipas projektit dhe mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, ku janë përcaktuar kategoritë dhe nënkategoritë përkatëse. Kjo kërkesë është vendosur nga Autoriteti Kontraktor me qëllim shqyrtimin e kualifikimit profesional të Ofertuesve në kuadër të veprimtarisë tregtare objekt prokurimi.

Detajini i kerkeses se cdo license sipas punimeve qe do te kryhen:

N.P – 1 Punime gërmimi në tokë. Konsiderohen gërmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gërmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.

1	3.89/b	Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet
2	3.89/a	Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet
3	3.124/1a	Germim shkambi mesatar me çekiç me ekskavator me zinxhir

1	2.426/3	Prishje shtrese betoni
---	---------	------------------------

N.P – 2 Ndërtime civile dhe industriale. Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta në objekte ku zhvillohen aktivitete njerëzore të drejtpërdrejta ose jo, kompletimi me strukturat e nevojshme dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar godina banimi, shkolla, zyra, kazerma ushtrie, teatro, stadione, godina industriale, godina për parkim, burgje, stacione hekurudhore dhe metroje, godina aeroporti me ndonjë punim special në betonarme të thjeshtë ose të paranderur, betonim të tavaneve të hollë, membrana, kupola, depozita të varura, sillos dhe ndërtime të larta me strukturë me karakteristika të veçanta e komplekse.

3	3.210	Shtrese çakelli mbeturine kave t=15cm, perhapur e ngjeshur makineri
4	3.212/b	Shtrese, stabilizant me trashesi 10 cm perhapur, niveluar dhe ngjeshur me makineri
5	3.243	Beton M - 200, shtrese ne trupin e rruges t=10cm
6	2.116	F V hekur betoni i zakonshem Ø 6 ~ 10mm, per zgaren e betonit Ø6 mm
7	An.4	Shtrese me pllaka guri te prera ranor me trashesi 3-5 cm, te vendosura me llac te zakonshem ne trupin e rruges
2	3.210	Shtrese çakelli mbeturine kave t=15cm, perhapur e ngjeshur makineri
3	3.212/b	Shtrese, stabilizant me trashesi 10 cm perhapur, niveluar dhe ngjeshur me makineri
4	3.243	Beton M - 200, shtrese ne trupin e rruges t=10cm
5	2.116	F V hekur betoni i zakonshem Ø 6 ~ 10mm, per zgaren e betonit Ø6 mm
6	3.243	Beton M - 200, per borduren mbrojtese tortuarit dhe lulishtes me t=15cm
7	An.4	Shtrese me pllaka guri te prera ranor me trashesi 3-5 cm, te vendosura me llac te zakonshem ne trupin e rruges

NP -4 A Rruge, autostrada, mbikalime, hekurudha , tramvaj, metro, pista aeroportuale. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar rrugët, pavarësisht nga shkalla e tyre e rëndësisë, autostradat, superstradat përfshirë ndërhyrjet në pika të veçanta, tunelet, devijimet në nivele dhe në lartësi, parkimet, punime të mureve mbajtëse, hekurudha, metro, hekurudhë me kavo, tranvai, pista aeroportuale, sheshet e helikopterëve, sheshet të realizuara me materiale të veçanta, natyrale dhe artificiale, urat, si dhe komplekse karakteristikash teknike, në hekur, betonarme të thjeshtë dhe të paranderur, parafabrikat ose të prodhuar në objekt. Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturim i ndërhyrjeve në rrjetin rrugor të nevojshëm për të ndjerë paqëndrueshmërinë mbi “goma”, “hekur”, “zona”, kushdo që të jetë

shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo vepre lidhëse, plotësuese ose pajisje edhe e tipit të veçantë, të linjës hekurudhore

I - PUNIME PER TRUPIN E RRUGES		
7	3.210	Shtrese çakelli mbeturine kave t=15cm, perhapur e ngjeshur makineri
8	3.212/b	Shtrese, stabilizant me trashesi 10 cm perhapur, niveluar dhe ngjeshur me makineri
9	3.243	Beton M - 200, shtrese ne trupin e rruges t=10cm
10	2.116	F V hekur betoni i zakonshem Ø 6 ~ 10mm, per zgaren e betonit Ø6 mm, zgaren e kanalit
11	3.243	Beton M - 200, per kanalim pergjat rruges dhe borduren mbrojtese
12	An.1	Shtrese me pllaka guri te crregullta me trashesi 3-5 cm, te vendosura me llac te zakonshem ne trupin e rruges
13	An -22	Pusete b/a shiu 40 x 40 cm, h = 100 cm, me kapak zgare hekuri
3	3.210	Shtrese çakelli mbeturine kave t=15cm, perhapur e ngjeshur makineri
4	3.212/b	Shtrese, stabilizant me trashesi 10 cm perhapur, niveluar dhe ngjeshur me makineri
5	3.243	Beton M - 200, shtrese ne trupin e rruges t=10cm
6	2.116	F V hekur betoni i zakonshem Ø 6 ~ 10mm, per zgaren e betonit Ø6 mm
7	An.1	Shtrese me pllaka guri te crregullta me trashesi 3-5 cm, te vendosura me llac te zakonshem ne trupin e rruges

NP-7 A Ujesjelles, gazsjelles, vajsjellesa, vepra kullimi e vaditje. Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshme për realizimin “e shërbimit hidrik kompleks” ose për transportimin në vendet e përdorimit të gazrave, vajrave dhe veprave lidhëse, plotësuese ose ndihmëse edhe në pika të veçanta si edhe në të gjitha impiantet mekanik të nevojshme për të pasur një shërbim të mirë të nevojshëm gjatë përdorimit, funksionimit, informimit, sigurisë dhe asistencës për një funksionim normal. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar veprat e kaptazhit të ujit, impiantet e trajtimit të ujit të pijshëm, ujësjellësit, kullat e ujit, stacionet e pompimit, depozitat në tokë ose të ngritura, rrjetin shpërndarës deri tek përdoruesi, furnizimi dhe vendosja në vepër e tubacioneve, shkarkimet e ujërave të zeza, si dhe trajtimin e ujërave të përdorura.

1	3.124/1a	Germim shkambi mesatar me çekiç me ekskavator me zinxhir
2	2.37/4a	Transport per largimin e dherave dhe mbetjeve
3	2.19/a	Hedhje, rafshim, mbushje
4	2,258	Shtrese zhavorri per perforcim tabani 50 cm
5	2,258	Shtrese zhavorri 20 cm
6	2.262/3	Shtrese betoni C12/15, 10 cm

7	3.624	Izolim me asfalt 2 cm
8	3/248	Beton C30/37 dysHEME 30 cm
9	3/248	Beton C30/37 per muret
10	3/248	Beton C30/37 solete, 25 cm
11	2.117/1	Beton C16/20 kollonat
12	2.262/4	Shtrese betoni C 16/20 per pjerresi
13	2.166	F V hekur betoni periodik
14	3.631	Suvatim me llac cemento 1:2 muret brenda
15	3.631	Suvatim me llac cemento 1:2 kollonat
16	3.631	Suvatim me llac cemento 1:4 muret jashte
17	3.631	Suvatim me llac cemento 1:4 tavani
18	2.264	Shtrese me llac cemento 1:2 dysHEMEja
19	3.624	Hidroizolim dy duar bitum muret jashte
20	3.624	Hidroizolim dy duar bitum soleta
21	2.182	Kapak llamarine t=4mm dhe zgare rrethimi+shkalle
22	4.121/2	F.V. saracineska celiku me fllanxa, Pn25 bar, ϕ 50
23	4.61	F.V. pjese speciale celiku ϕ ÷200 te pa izoluar per ujesjellsa te jashtem
24	2.491/a	F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=20~25mm, PN 25
25	An.3	Cesma guri me dy dalje se bashku me rakorderit hidraulike

N.S – 1 Punime për prishjen e ndërtimeve. Konsiderohet çmontimi i impianteve industriale dhe prishja komplet e ndërtesave me pajisje speciale ose me përdorim eksplozivi me prerje të strukturave betonarmeje dhe prishjeve në përgjithësi përfshi edhe grumbullimin e mbeturinave, ndarjen e tyre dhe riciklimin e materialeve.

5	2.426/2	Prishje mur tulle + pastrim
6	2.426/3	Prishje shtrese betoni

N.S – 18 Punime topogjeodezike Konsiderohet zbatimi i rlevimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh.

Per zbatimin dhe piketimin ne terren te planeve te vendosjes te objekteve , nxjerrjen e niveleve dhe kuotave . .

Argumenti i permbledhur : Referuar VKM-se nr.42

Kategoria e	Pershkrimi i	Zërat e punimeve që parashikohen të	Niveli i
-------------	--------------	-------------------------------------	----------

kërkuar	kategorisë sipas legjisllacionit të fushës	kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive
NP 1 - A	(Punime gjermimi në tokë)	Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me gjermime në tokë, kryesisht për punime prishje, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.	0-20
NP 2 - A	(Ndërtime civile dhe industrial)	Në Preventivin e Punimeve referuar dhe fleteve teknike të projektit kemi Rikonstruksion të godines ekzistuese me punime shtresash, punime suvatimesh, punime baze betoni , punime shtresash , veshje me pllaka, punime tarace, etj., Referuar sa me sipër sipas kërkesave të projektit në pikën NP-2 konsiderohen <u>ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta në objekte ku zhvillohen aktivitete njerëzore të drejtpërdrejta ose jo</u> , kompletimi me strukturat e nevojshme dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar shkollë.	0-20
NP 4- A	Rruge, autostrada, mbikalime, hekurudha , tramvaj, metro, pista aeroportuale	Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me ndërhyrjet në rrugë . konkretisht sipas përshkrimit të pikës NP-4 Rruge, autostrada, mbikalime, hekurudha , tramvaj, metro, pista aeroportuale Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.	0-20
NP 7- A	Ujesjelles, gazsjelles, vajsjellesa, vepra kullimi e vaditje	Është e nevojshme që OE që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me këtë kategori me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses pasi për	0-20

		realizimin e kësaj kontrate ka punime lidhen meNP 7 ku sipas përshkrimit konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshme realizimin e shërbimit hidrik	
NS 1- A	Punime për prishjen e ndërtimeve	Ne preventiv është parashikuar prishje suvatimi , prishje mur tulle, etj qe konsistojne ne prishje komplet përfshi edhe grumbullimin e mbeturinave, ndarjen e tyre dhe riciklimin e materialeve.	0-20
NS-18 A	Punime topogjeodezike	Ne preventive dhe projekt janë parashikuar zëra/element te punimeve ne rruges qe nevojiten piketime te rruges, planeve te vendosjes te objekteve , nxjerrjen e niveleve dhe kuotave .	0-20

2.3.3- Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë fuqi punëtore minimalisht **16 persona**. Si dëshmi për fuqinë punëtore do të dorëzohen dokumentet si më poshtë;

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për muajin e fundit te cilit I takojne pagesat me daten e hapjes se ofertave .
- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën për muajin e fundit te cilit I takojne pagesat me daten e hapjes se ofertave .,

Ky kriter konsiderohet i permbushur me paraqitjen e formularit te vetdeklarimit sipas shtojces 8.

Shënim:Autoriteti Kontraktor do te beje verifikimin e dokumentacionit ne perputhje me vetedeklarimin e bere gjate fazes se ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit te dorezuar perben kusht s'kualifikimi. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të paraqesi dokumentacionin provues, original ose te noterizuar sipas deklarates së mesiperme përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit , brenda afatit nga dërgimi i njoftimi për paraqitjen e tyre.

Argumentimi: Në përcaktimin e numrit te punonjësve specialisti i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, afati i realizimit te kontrates, orët e punës etj.. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështirje per te pakten muajin e fundit , tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën.

Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në

regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpigjet të kufizojë edhe problematikën sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës. Numri i punonjësve që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore në zbatim të tij.

Për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj është kërkuar edhe dëshmi të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, sipas së cilës: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

2.3.4- Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë**, si më poshtë:

- 1 (nje) Inxhinier Ndërtimi,
- 1 (një) Inxhinier Gjeodet(Topograf)

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

- Për secilin pjestar të stafit teknik të mesiperm duhet të paraqesë, Kontrate pune e vlefshme, diplome , (Drejtuesit teknik të jone të siguruar sipas legjislacionit në fuqi për periudhën për muajin e fundit të cilit I takojne pagesat me datën e hapjes së ofertave)

Ky kriter konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8. Shënim: Autoriteti Kontraktor do të beje verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetedeklarimin e bere gjate fazes se ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar perben kusht s’kualifikimi. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të paraqesi dokumentacionin provues, original ose të noterizuar sipas deklaratës së mësipërme përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit , brenda afatit nga dërgimi i njoftimi për paraqitjen e tyre.

Argumentimi Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, projekt idene në termat e references, volume e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të ndërtim, gjeodet etj është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

- 1 (nje) Inxhinier Ndërtimi,
- 1 (një) Inxhinier Gjeodet(Topograf)

(Arg: Objekti eshte rikonstruksion dhe rehabilitimi I rrugeve te varrezave te vjetra dhe lagjeve me nderhyrje ne pridhje ne mure dhe shtrese betoni , shtrese cakell, stabilizanti etj

2.3.5. Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- - 1 (një) Inxhinier hidroteknik

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- *Për secilin pjestar te stafit teknik te mesiperm duhet te paraqese, Kontrate pune e vlefshme dhe diplome ,, (Stafi mbeshtetes te jene te siguruar sipas legjislacionit ne fuqi për periudhën për muajin e fundit te cilit I takojne pagesat me daten e hapjes se ofertave)*

Ky kriter konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit te vetdeklarimit sipas shtojces 8.

Shënim:Autoriteti Kontraktor do te beje verifikimin e dokumentacionit ne perputhje me vetedeklarimin e bere gjate fazes se ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit te dorezuar perben kusht s'kualifikimi. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të paraqesi dokumentacionin provues, original ose te noterizuar sipas deklaratës së mësipërme përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit , brenda afatit nga dërgimi i njoftimi për paraqitjen e tyre.

Argumentimi Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “ç”.

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës.Nëpërmjet këtij kushti kërkohet që të vërtetohet se Ofertuesit zotërojnë kapacitetet e nevojshme teknike lidhur me stafin që kanë në dispozicion,të cilat i japin garancitë e nevojshme autoritetit Kontraktor mbi përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.Stafi teknik mbeshtetes do jetë përgjegjës për të ekzektuar kontratën objekt prokurimi në zbatim të plotë me Projektin e zbatimit si dhe brenda afatit të parashikuar në Njoftimin e Kontratës.

- 1 (një) Inxhinier hidroteknik

(Arg: Punimet jane te natyres Kapak llamarine dhe zgare rrethimi+shkalle, F.V. saracineska celiku me fllanxha, Pn25 bar, φ50,F.V. pjese speciale celiku φ=200 te pa izoluar per ujesjellsa te jashtem , F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=20~25mm, PN 25 Cesma guri me dy dalje se bashku me rakorderit hidraulike etj.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet disponoje punonjës të specializuar/ kualifikuar si më poshtë:

- Operatorët ekonomik të kenë në stafin e tyre **1 (një)** punonjës të pajisur me çertifikatë “Kordinator për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, në përputhje me klauzolat e **ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”** dhe V.K.M-së Nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”. Për këtë duhet të paraqitet çertifikata e trajnimit e dhënë nga një organizem i licensuar, shqiptar ose i huaj, kontratën e

punës të vlefshme dhe të figuroj në listëpagesat e shoqërisë për periudhën për muajin e fundit të cilit I takojne pagesat me datën e hapjes së ofertave)

Ky kriter konsiderohet i permbushur me paraqitjen e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8. Shënim: Autoriteti Kontraktor do të beje verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetdeklarimin e bere gjate fazes së ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorezuar perben kusht s'kualifikimi. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të paraqesi dokumentacionin provues, original ose të noterizuar sipas deklaratës së mësipërme përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit , brenda afatit nga dërgimi i njoftimi për paraqitjen e tyre.

Argumentimi Kërkesa e mësipërme është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", si dhe ligjin 8402 "Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" date 10.09.1998 i ndryshuar, ligjin Nr. 10237 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier" si dhe ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", ligjit nr. 152/2015 /25 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin", të Ligjit nr.124/2015 "Për efikasitetin e energjisë".

Natyrë e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri të përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes. Kërkesa për Përgjegjësin për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma "c", si dhe në mbështetje të Nenit 7 të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010 „Për sigurinë dhe shëndetin në punë“, sipas të cilit: „Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë.....“.

Theksojmë se, Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me kantierin e ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve.

Për sa më lart, punonjësi i cili duhet të jete të certifikuar si "koordinator për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë", nëpërmjet dijes dhe eksperiencës të fituar në këtë fushë, duhet të shmangin apo parandalojnë çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që mund të çënojnë shëndetin apo sigurinë në punë. Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që Ofertuesit do të realizojnë punimet sipas standarteve ligjore në fuqi.

2.3.7- Kandidati ofertues duhet të përcaktoje me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm: diplome, libere pune dhe kontrate pune të vlefshme.

Deklarata e administratorit te shoqerohet edhe me dhenien e nje deklarate personale nga vete drejtuesi teknik i OE.***Ky kriter konsiderohet i permbushur me paraqitjen e formularit te vetdeklarimit sipas shtojces 8. Shënim:Autoriteti Kontraktor do te beje verifikimin e dokumentacionit ne perputhje me vetedeklarimin e bere gjate fazes se ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit te dorezuar perben kusht s'kualifikimi.*** Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të paraqesi dokumentacionin provues, original ose te noterizuar sipas deklaratës së mësipërme përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit , brenda afatit nga dërgimi i njoftimi për paraqitjen e tyre.

Argumentimi *Kjo kërkesë mbështetet ne Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.*

Referuar rekomandimit te app nr. 6732 prot date 21.10.2020, te cituar :

Sjellim në vëmendje të autoriteteve kontraktore, se në Kreun I/2.1, të Udhëzimit nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, përcaktohet qartësisht se: “Drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejt nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit. Për vepra me vlerë të plotë, të preventuar mbi 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe i diplomuar në inxhinieri ndërtimi”.

Sa më sipër, rekomandojmë që autoritetet kontraktore të mbajnë në konsideratë dispozitën e sipërcituar, kur parashikojnë kërkesat për disponueshmërinë e drejtuesve teknik në objekt.

Nga ana tjetër, konstatohet se për përmbushjen e këtij kushti, operatorëve ekonomikë u kërkohet të paraqesin një vetdeklarim që drejtuesi/t teknik të punimeve do të jenë të pranishëm në objekt apo se nuk janë të angazhuar në kontrata të tjera. Me qëllim shmangien e keqinformimit apo paraqitjes të dokumentave me të dhëna të rreme, sa i takon deklaratës që ato japin, rekomandojmë që së bashku me deklaratën e operatorit ekonomik, të kërkohet edhe dhënia e deklaratës nga vetë drejtuesi teknik i operatorit ekonomik, pra dhënia e një deklarate personale, e cila do të bashkëshoqërojë deklaratën e subjektit.

2.3.8- Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar punonjes specialistë të kualifikuar ne profilet perkatese si më poshtë:

- Karpentiere 2 (dy)
- Hekurthyes 1 (nje)
- Saldator 1 (nje)
- Mekanik 1 (nje)
- Murator 2(dy)
- Pllakashtrues 1 (nje)
- Punetor/Specialist ndertimi 1 (nje)
- Manovrator 1(nje)
- shofere 1 (nje)
- Puntor krahu i thjesht 1 (nje)

Per punonjesit te paraqitet Kontrate pune e vlefshme, certifikatat perkatese si edhe te figurojne ne listepagesat e shoqerise. *për periudhën për muajin e fundit te cilit I takojne pagesat me daten e hapjes se ofertave .*

-Për manovratorët të paraqitet kontrata e punës dhe dëshmia e aftësisë profesionale lëshuar nga DPSHTRR . **(Në rastin kur punonjësit e mësipërm janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).**

-Operatori ekonomik duhet të ketë 1 (një) Teknik Ndertimi të cilet duhet të jenë të pajisur me Kontrate pune të rregullt, diplome perkatese/deshmi kualifikimi, certificate sigurimi teknik si dhe të figurojnë në listpagesën e shoqërisë për periudhën për muajin e fundit të cilit I takojnë pagesat me datën e hapjes së ofertave)

Ky kriter konsiderohet i permbushur me paraqitjen e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8. Shënim: Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetedeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetedeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht s'kualifikimi. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të paraqesi dokumentacionin provues, original ose të noterizuar sipas deklaratës së mësipërme përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit , brenda afatit nga dërgimi i njoftimit për paraqitjen e tyre.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “ç”.

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas projekt idese si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarohet se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-iden duke marrë në konsideratë volumet e punës që do të realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve të percaktuara në projekt ide.

1 (një) saldatore

(Arg: Për proceset e punimeve të saldimit të Konstruksioneve metalike të thjeshta për rrethim dhe portën kryesore, saldimit të Tubve e rakorderi ujësjes etj

1 (një) punonjës hekurthyes

(Arg: Për proceset e punimeve me hekur që do të kryhen Punime betoni dhe hekuri

2(dy) punonjës karpentierë

(Arg: Për proceset e punimeve betoforme, Punime betoni dhe b/a e hekuri

1 (një) punonjës pllakashtrues

(Arg: Për punimet e shtrimit të Shtresës me pllaka guri të prera ranor me trashësi 3-5 cm, të vendosura me llac të zakonshëm në trupin e rruges etj

2 (dy) murator

(Arg: Për proceset e punimeve të muratues Veshje muri me pllaka guri+parmaku i murit etj

1 (një) manovrator

(Arg: Për mbajtjen dhe drejtimin e fadromës dhe eskavatorit me zinxhir me çekic)

1 (një) Punëtor/specialist ndertimi

(Arg: Për Punimet e ndryshme, prishje, levizje materiale etj

1 (nje) shofer

Arg: Për mbajtjen dhe drejtimin e kamioncinave)

1 (nje) Teknik Ndertimi

(Arg: Per punime te ndryshme ndertimi qe ka objekti dhe organizimin e puntoreve per kryerjen e punimeve sipas grafikut te punimeve)

2.3.9 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

<i>Nr</i>	<i>Lloji i Makinerive</i>	<i>Statusi</i>	<i>Sasia</i>
1	<i>Kamion vetëshkarkues kapacitet mbajtës min. 10 ton</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
2	<i>Kamioncine 3 deri ne 5 ton</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
3	<i>Kamioncine deri ne 1-3 ton</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
4	<i>Kamion me Vinc me kapacitet mbajtës 5-10 ton</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
5	<i>Fadrome me Goma</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
6	<i>Eskavator me zinxhir me cekic</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Cope 1</i>
7	<i>Grejder</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Cope 1</i>
8	<i>Autobot uji</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
9	<i>Autopompe betoni</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Cope 1</i>
10	<i>Autobetoniere</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
11	<i>Vibrator betoni</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
12	<i>Autobetoniere kantieri 2.5 m3</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
13	<i>Armatura druri (betoforma) 150 m2</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>150 m2</i>
14	<i>Depozite uji 1000l-5000l</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Cope 1</i>
15	<i>Pajisje niveluese per nivelim shtresash</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
16	<i>Gjenerator</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
17	<i>Elektrosaldatrice</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton pronësinë e mjetit:- certifikatën e pronësisë; -leja e qarkullimit; - certifikatën e kontrollit teknik; siguracionin; certifikatën e transportit të mallrave ;fotot përkatëse ku të duket qartë targa;
- Ndërsa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mesipër, duhet të paraqitet edhe kontrata notoriale e qirase, e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve, shoqëruar me certifikatën e pronësisë; -leja e qarkullimit; -

çertifikaten e kontrollit teknik; siguracionin; fotot perkatese ku te duket qarte targa, certifikata e transportit te mallrave per perdorim vetja dhe per te tretet ;

- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore perkatese, fotot ku te duket qarte dhe sherbimi i tij, ndersa per mjete te marra me qira krahas dokumentacionit te mesiperme, duhet te paraqitet edhe kontrata noteriale e qirase, e cila duhet te jete e vlefshme per te gjithë periudhen deri ne perfundimin e plote te punimeve.

Ky kriter konsiderohet i permbushur me paraqitjen e formularit te vetdeklarimit sipas shtojces 8. Shënim: Autoriteti Kontraktor do te beje verifikimin e dokumentacionit ne perputhje me vetedeklarimin e bere gjate fazes se ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit te dorezuar perben kusht s'kualifikimi. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të paraqesi dokumentacionin provues, original ose te noterizuar sipas deklaratës së mësipërme përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit , brenda afatit nga dërgimi i njoftimi për paraqitjen e tyre.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Argumentimi: *Kërkesa e mesiperme eshte vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa "d" të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Nepermjet ketyre kerkesave, Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë në dispozicion apo që mund t'u vihen në dispozicion me qellim permbushjen me sukses te kontratës objekt prokurimi. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të detyres se projektimit. Mjetet jane percaktuar sipas nevojës se zbatimit te projektit si me poshte:*

<i>Kamion vetëshkarkues kapacitet mbajtës min. 10 ton</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
---	-------------------------------	---------------

Kamioni eshte i domosdoshem pasi sipas preventivit kemi te gjitha punimt e prishjes prishje pllakave,prishje mur tulle. Nepermjet ketyre mjeteve do te behet transportimi I te gjitha materialve (mbetjeve) drejt vendit te depozitimit te percaktuar nga autoriteti kontraktor. Njekohesisht keto mjete do te nevojiten per te sjelle ne kantier te gjitha inertet,materialet e ndryshme te renda, gure per shtrim, etj...

<i>Kamioncine 3 deri ne 5 ton</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
<i>Kamioncine deri ne 1-3 ton</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>

Keto mjete do te nevojiten per te sjell ne kantier materialet e lehta dhe vegla pune nga me te ndryshme ne kantier,po ashtu do te bejne te mundur dhe transportimin e stafit se bashku me puntoret cdo dite nga kantieri.

<i>Kamion me Vinc me kapacitet mbajtës 5-10 ton</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
---	-------------------------------	---------------

Ky kamion do te nevojitet per transporte te ndryshme te materialeve.

<i>Fadrome me Goma</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
------------------------	-------------------------------	---------------

Eskavator me zinxhir me cekic	në pronësi ose me qira	Copë 1
-------------------------------	------------------------	--------

Te dyja keto mjete do te sherbejne per shkarkimin dhe ngarkimin e materialeve te ndryshme ne kantier,po ashtu per sistemimin e rrugeve .

Autobot uji	në pronësi ose me qira	Copë 1
-------------	------------------------	--------

Per furnizimin ne kantier me uje

Autobetoniere	Në pronësi ose me qera	Copë 1
Autopompe betoni	në pronësi ose me qira	Copë 1
Vibrator betoni	në pronësi ose me qira	Copë 1

Keto mjete do te sherbejn per sjelljen e betonit per shtresat e ndryshme te planifikuara ne project, per dergimin e betonit ne zona te ndryshme nepermjet autopompe se betonit dhe Vibratori I betonit do te kryej procesin e vibrimit dhe berjen sa me kompakt sipas kushteve teknike betonin e kerkuar ne kantier.

Armatura druri (betoforma) 150 m2	në pronësi ose me qira	150 m2
------------------------------------	------------------------	--------

Betoforme per traret dhe brezat dhe shtresat e planifikuara ne project

Depozite uji 1000l-5000l	në pronësi ose me qira	Copë 1
--------------------------	------------------------	--------

Per mbajtjen e ujit per punime te ndryshme ne kantier .

Pajisje niveluese per nivelim shtresash	në pronësi ose me qira	Copë 1
---	------------------------	--------

Per nivelimin e shtresave te ndryshme

Gjenerator	në pronësi ose me qira	Copë 1
Elektrosaldatrice	në pronësi ose me qira	Copë 1

Per furnizimin me energji elektrike ne kantier gjithashtu energji per venien ne pune te paisjeve te ndryshme, ndersa elektrosaldatricja per saldimin e hekurave te ndryshem te zgarave .

Argumentimi për dokumentacionin e kërkuar për mjetet:

“ Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar , neni 79/3 parashikon shprehimisht se “Të gjitha mjetet që qarkullojnë dhe hyjnë në territorin e Republikës së shqipërisë, janë të detyruara të kalojnë në kontrollin teknik vjetor dhe atë periodik”

Ligji nr. 10076, datë 12.2.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” neni 4 parashikon shprehimisht se: “Pronari i çdo mjeti transporti, përpara përdorimit të mjetit, është i detyruar të lidhë një kontratë sigurimi, sipas pikës 1 të nenit 2 të këtij ligji, si dhe të sigurojë rinovimin e saj për aq kohë sa mjeti i transportit do të mbetet në qarkullim”.

Ligji nr.8308 datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” neni 5 parashikon shprehimisht se :
“Veprimtaria e transportit rrugor për udhëtarë dhe mallra për të tretë dhe me qira, kryhet mbi bazën e licencës.”

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Per mjete e marra me qera , certifikata e transportit te mallrave duhet te jete leje transporti per mallrat per perdorim nga te tretet sipas rekomandimit nr.6732 te app si me poshte :

Referuar parashikimeve të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, mjetet mund të caktohen për përdorim vetjak ose për përdorim nga të tretët (kur mjetet shfrytëzohen, kundrejt pagesës përkatëse, nga persona të tjerë të ndryshëm nga titullari i lejes së qarkullimit).

Kur mjetet janë për përdorim nga të tretët, duhet të pajisen me leje transporti që lëshohet për këtë qëllim. Ndërkohë, APP ka konstatuar se operatorët paraqesin në procedurë kontrata noteriale, sipas të cilave kanë marrë me qira mjete, ndërkohë që referuar lejes së transportit, janë për përdorim vetjak dhe jo për përdorim nga të tretët.

Argumentimi: Kërkesat e mesiperme janë vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe Nenit 39, pika 6, germa”d” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që Operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Makineritë janë përcaktuar në raport me punimet e parashikuara në preventiv dhe volumet e tyre, numrin e puntorisë dhe kohëzgjatjen e ekzekutimit të kontratës.

2.3.10 .Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, të vlefshme (ose ekuivalente) për objektin që prokurohet, si me poshte :

ISO 45001-2018 Menaxhimi i Shëndetit dhe Sigurisë në Punë

Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mësipërme sipas zërave të punimeve që do të realizojë në përputhje me perqindjen .

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 10 gërma “a”- “c” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Nenit 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i

plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

ISO 45001-2018 është standard ndërkombëtar, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

Argumentim: *Kjo kerkese eshte bere ne perputhje me nenin 44/1 te VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: „Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”*

Kriteret për shpalljen e ofertës fituese

Bazuar në pikën 3, neni 45 Seksioni III VKM 285, datë 19.5.2021 PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK “Për punët/mallrat/shërbimet që kanë specifikime të thjeshta, standarde teknike të mirënjohura dhe janë lehtësisht të gjendura në treg, oferta ekonomikisht më e favorshme, bazohet **në çmimin si i vetmi element i ndryshueshëm ndërmjet ofertave**”.

Njesia e prokurimit:

Ferdinand Avdiaj	Inxhinier	KRYETAR
Sara Satka	Juriste (personi pergjegjes i prokurimeve publike)	ANETAR
Kristina Roma	Ekonomiste	ANETAR